



# GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË



Nr. 20 / 8 GUSHT 2022

## GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës e publikon: Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në mbështetje të Ligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-190.

Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës publikohen: Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës;

Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Vendimet e Gjykatës Kushtetuese; Dekretet e Presidentit të Republikës së Kosovës në rastet kur kërkohet nga Presidenti; Deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në rastet kur kërkohet nga Kryetari i Kuvendit; Aktet nënligjore të Qeverisë dhe të ministrive në rastet kur kërkohet nga Kryeministri dhe Aktet tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, si dhe INDEKS-i vjetor i Gazetës Zyrtare.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në pesë gjuhë: në gjuhën Shqipe, Angleze, Serbe, Turke dhe atë Boshnjake.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës administrohet nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Mbikëqyrja editoriale:

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës:

Arben Krasniqi

Drejtori i Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës:

Naser Canolli

Redaksia e Gazetës Zyrtare:

Hysen Bajramaj

Shqipe Fazliu-Gashi

Sedat Safçi

Besart Graiçevci

Adresa dhe Korrespondenca:

Ndërtesa e Re e Qeverisë,

Prishtinë

038-200-14039 / 038-200-14827

Ueb-faqja e Gazetës Zyrtare:

<http://gzk.rks-gov.net>

E-mail adresa: [Info-gzk@rks-gov.net](mailto:Info-gzk@rks-gov.net)

Dizajni dhe Printimi:

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

NË RAST MOSPËRPTHJE NDËRMJET VERSIONEVE GJUHËSORE TË AKTEVE JURIDIKE TË BOTUARA  
DHE TË PUBLIKUARA NË GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËRPARËSI DO TË KENË  
GJUHËT ZYRTARE NË PËRPTHJE ME KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



**PËRMBAJTJA**

LIGJI NR. 08/L-129 PËR SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS.....1

LIGJI NR. 08/L-131 PËR SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS.....11



**LIGJI NR. 08/L-129****PËR SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të Nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS****KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1  
Qëllimi**

Ky ligj përcakton statusin, parimet dhe organizimin e përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës, me qëllim të rehabilitimit dhe ri integritimit shoqëror të personave nën mbikëqyrje, gjithashtu, parandalimin e veprave penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së tyre, si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e interesit publik.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet për të gjithë zyrtarët publik në Shërbimin Sprovues të Kosovës.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Shërbimi Sprovues i Kosovës-SHSK** - është institucion që merret me organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht, si dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj;
- 1.2. **Drejtoritë Rajonale** - drejtoritë regjionale që veprojnë në kuadër të SHSK-së;
- 1.3. **Menaxheri i rastit** - është zyrtari sprovues i cili përgatitë anketën e plotë sociale dhe raportin para ndëshkues, mbikëqyrë ekzekutimin e masave apo dënimeve alternative, mbikëqyrjen e të liruarve me kusht dhe përkujdesjen pas lirimit për të mitur;
- 1.4. **Personi nën mbikëqyrje** - i referohet çdo personi i cili është i përfshirë në mbikëqyrjen e Shërbimit Sprovues, në bazë të vendimit nga autoriteti kompetent;
- 1.5. **Raporti para ndëshkues** - është raport i përgatitur nga zyrtari sprovues, sipas kërkesës së Gjykatës me qëllim të propozimit dhe përzgjedhjes së masës apo dënimit më të përshtatshëm;
- 1.6. **Raporti** - është një dokument zyrtar i përgatitur për personin nën mbikëqyrje nga menaxheri i rastit/zyrtari sprovues për Gjykatë, Prokurori, Panelin për Lirim me Kusht dhe institucionet tjera relevante;

1.7. **Vlerësimi i rrezikshmërisë** - vlerësimin e përsëritjes së veprës penale, rrezikun që paraqet për shoqërinë si dhe rrezikun për vetëvrasje apo vetëlëndim të personave nën mbikëqyrje.

1.8. **Dënime Alternative** - siç parashihen në Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur janë të gjitha dënimet që ekzekutohen në komunitet dhe kanë për qëllim ri integrimin dhe risocializimin e personave të dënuar në shoqëri;

1.9 **Anketa Sociale**- raport të plotë social për te miturin me kërkesë te prokurorit te shtetit apo gjykatës. Anketa sociale përfshin te dhëna mbi moshën e të miturit dhe zhvillimin psikologjik, biografinë e familjes, biografinë dhe rrethanat nën te cilat jeton i mituri, nivelin shkollor, përvojën edukative dhe çfarëdo te dhënë tjetër relevante.

## KAPITULLI II STATUSI, VEPRIMTARIA DHE BUXHETI I SHSK-së

### Neni 4

#### Statusi, veprimtaria dhe selia e Shërbimit Sprovues të Kosovës

1. Shërbimi Sprovues i Kosovës është Agjenci ekzekutive e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. SHSK është i pavarur në kryerjen e funksionit të vet në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.
3. Shërbimi Sprovues i Kosovës ka shenjat identifikuese, të cilat miratohen nga Ministri pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm.

### Neni 5

#### Parimet

1. Zyrtarët publik të Shërbimit Sprovues të Kosovës ushtrojnë detyrën në bazë të parimeve të:
  - 1.1. **Ligjshmërisë**- SHSK ushtron të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë në bazë të legjislacionit në fuqi si dhe instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.
  - 1.2. **Efektshmërisë dhe efikasitetit** – zyrtarët publik të SHSK-së duhet të sigurojnë zbatimin e ligjeve, rregullave dhe procedurave administrative dhe të sigurisë për përmbushjen e objektivave të SHSK-së;
  - 1.3. **Barazisë dhe mos-diskriminimit** -nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi.
  - 1.4. **Transparencës**- SHSK ndjek një qasje të hapur për qytetarët dhe palët e tjera të interesit lidhur me punën e tij;
  - 1.5. **Komunikimit** - bëhet në një gjuhë të kuptueshme nëse personi nuk flet apo nuk kupton gjuhën zyrtare dhe në mënyrë të pranueshme për personat me aftësi të kufizuara, sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi përmes metodave më të përshtatshme
  - 1.6. **Respektimit të jetës private të personit nën mbikëqyrje dhe familjes së tij**- zyrtarët publik gjatë punës së tyre udhëhiqen nga standardet e larta etike, integritetit, meritës dhe profesionalizmit. Zyrtarët gjatë punës së tyre kujdesen për ruajtjen e dinjitetit dhe integritetit të personit nën mbikëqyrje dhe familjes së tij.



1.7. **Mbrojtjes së të dhënave**- informacioni i krijuar dhe i administruar për shkak të funksionit, realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

1.8. **Shmangies së konfliktit të interesit** – zyrtarët publik të SHSK-së kanë detyrimin të shmangin çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në pajtim me ligjin.

1.9. **Llogaridhënies**- zyrtarët publik të ShSK-së obligohen që të japin llogari lidhur me ushtrimin e autorizimeve të tyre krahas ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të punës në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **Neni 6** **Veprimtaria e Shërbimit Sprovues**

1. Shërbimi Sprovues është përgjegjës për kryerjen e punëve lidhur me:

1.1. organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative me qëllim të ri integritetit shoqëror të personave të dënuar;

1.2. përgatitjen e anketës sociale dhe raportet para-ndëshkuese për kryerësit e veprave penale;

1.3. vlerësimin i rrezikut dhe nevojave për trajtim të kryesve të veprave penale;

1.4. ekzekutimin e masave të diversitetit dhe masave edukative për të mitur;

1.5. mbikëqyrjen, mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme ndaj personave të dënuar gjatë ekzekutimit të dënimeve alternative;

1.6. mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj kryerësve të varur nga droga ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues i cili mbahet në liri;

1.7. mbikëqyrjen dhe ndihmën ri- integruese dhe ri-socializuese ndaj personave të liruar me kusht;

1.8. zhvillimi i programeve individuale të mbikëqyrjes siç përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi;

1.9. hartimin e raporteve për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative si dhe personave të liruar me kusht për Prokurorin e Shtetit, Gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht;

1.10. udhëzimin dhe mbështetjen për personat e dënuar me kusht në përfundim të dënimit të tyre;

1.11. mbajtjen e evidencave dhe regjistrave për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative si dhe raporteve;

1.12. propozon ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit nga fushë- veprimtaria e SHSK-së;

1.13. kryen edhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Shërbimi Sprovues bashkëpunon me organet e pushtetit qendror dhe lokal, personat juridik dhe me institucione tjera relevante në zbatimin e mbikëqyrjes.

### **Neni 7**

#### **Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit Sprovues të Kosovës**

1. Shërbimi Sprovues i Kosovës për kryerjen e punëve dhe detyrave funksionon sipas kësaj strukture organizative si ne vijim:

1.1. Drejtoria e Përgjithshme është strukturë organizative e nivelit qendror e cila funksionon me Departamente dhe Divizione;

1.2. Drejtoritë rajonale janë strukturë organizative e SHSK-së të cilat përcaktohen sipas shtrirjes territoriale të gjykatave.

2. Organizimi i brendshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe sistematizimi i vendeve të punës, rregullohet me akt nënligjor siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 8**

#### **Buxheti dhe menaxhimi financiar**

1. Shërbimi Sprovues i Kosovës ka buxhetin e vet të ndarë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Buxheti i SHSK-së, përgatitet në përputhje me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.

3. Buxheti mbulon koston e plotë të funksionimit të SHSK-së për garantimin e menaxhimit të vazhdueshëm sipas standardeve përkatëse.

### **Neni 9**

#### **Raportet ndërmjet Shërbimit Sprovues dhe Ministrisë së Drejtësisë**

1. Shërbimi Sprovues i Kosovës funksionon nën autoritetin e Ministrit të Drejtësisë dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSK-së.

2. Drejtori i Përgjithshëm raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit për administrimin dhe menaxhimin e SHSK-së.

3. Drejtori i Përgjithshëm bashkëpunon me Ministrin dhe i ofron informata dhe raporte atij sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

### **Neni 10**

#### **Drejtoria e Përgjithshme**

1. Drejtoria e Përgjithshme e SHSK-së është përgjegjëse për:

1.1. mbikëqyrë ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të Drejtorive Rajonale përmes mekanizmave të saj;

1.2. harton rregulla, standarde dhe procedura nga fushë-veprimtaria e SHSK-së;

1.3. mbledhë dhe përpunon të dhëna nga fushë-veprimtaria e vet dhe i ndanë me organet e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi;

1.4. koordinon zhvillimin dhe implementimin e politikave strategjike shtetërore për të përmbushur obligimet e Shërbimit Sprovues;

1.5. në pajtim me institucionet relevante kujdeset për sigurimin e kushteve të punës, shëndetit dhe sigurisë për zyrtarët publik të SHSK-së;

1.6. mbikëqyrë funksionet administrative të SHSK-së, në menaxhimin e burimeve njerëzore, planifikimin e personelit, trajnimin dhe aftësimin e personelit të SHSK-së në mirëmbajtjen e të dhënave, sistemin e bazës së të dhënave, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare si dhe shërbimet e përgjithshme;

1.7. bashkëpunon me institucionet shtetërore, agjencitë e zbatimit të ligjit, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, kulturore, fetare dhe akterët e tjerë relevant vendor dhe ndërkombëtar;

1.8. kryen punë të tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Sprovues drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSK-së.

3. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSK përbëhet nga:

3.1. Drejtori i Përgjithshëm;

3.2. Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, dhe

3.3. Nëpunës administrativ dhe mbështetës.

#### **Neni 11**

#### **Emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues**

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues emërohet në pajtim me dispozitat përkatëse për emërimet të larta sipas Ligjit për Zyrtarët Publik.

#### **Neni 12**

#### **Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm në kuadër të funksioneve të tij ka këto përgjegjësi:

1.1. udhëheqë dhe përfaqëson SHSK- në;

1.2. planifikon, zhvillon, administron dhe menaxhon SHSK-në dhe është përgjegjës për garantimin e zbatimit të funksioneve që janë përcaktuar me legjislacionin në fuqi

1.3. zbaton obligimet që rrjedhin nga Politikat Strategjike Shtetërore të Qeverisë së Republikës së Kosovës;

1.4. mbikëqyrë punën e Drejtorive rajonale;

1.5. planifikon dhe ekzekuton buxhetin si dhe miratimin e pagesave sipas legjislacionit në fuqi;

1.6. mbikëqyr hartimin e politikave të SHSK-së;

1.7. mbikëqyr ligjshmërinë e punës dhe të veprimtarisë së SHSK-së;

1.8. ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi lidhur me personat nën mbikëqyrje;

1.9. nxjerrë vendime, rregulla dhe procedura të brendshme për SHSK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.10 lidhë marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata në emër të SHSK-së me institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare, si dhe institucione ndërkombëtare me veprimtari të njëjtë;

1.11. kryen edhe detyra të tjera të përcaktuar me legjislacionin në fuqi;

1.12. Drejtori i Përgjithshëm për punën e SHSK-së i përgjigjet Ministrit të Drejtësisë.

### **KAPITULLI III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI**

#### **Neni 13**

#### **Llojet e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Sprovues dhe Shtrirja Territoriale e tyre**

1. Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga veprimtaria e Shërbimit Sprovues funksionojnë këto drejtori rajonale:

1.1. Drejtorja Rajonale Prishtinë;

1.2. Drejtorja Rajonale Prizren;

1.3. Drejtorja Rajonale Mitrovicë;

1.4. Drejtorja Rajonale Pejë;

1.5. Drejtorja Rajonale Gjilan;

1.6. Drejtorja Rajonale Ferizaj;

1.7. Drejtorja Rajonale Gjakovë.

2. Drejtoritë Rajonale për shkak të specifikave dhe kompleksitetit të veprimtarisë kryejnë detyrat të përcaktuar me këtë Ligj si dhe kanë shtrirje territoriale sipas përcaktimit të Gjykatave Themelore.

#### **Neni 14**

#### **Drejtoritë Rajonale**

1. Drejtorja rajonale është e obliguar të ushtroj funksionet përkatëse sipas autorizimeve si në vijim:

1.1. ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;

1.2. organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave nën mbikëqyrje;

1.3. mbështetja dhe ri-integrimi i personave nën mbikëqyrje;

1.4. koordinimi i punëve me institucionet relevante si dhe organet gjyqësor;

1.5. harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton për organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante;

1.6. harton dhe mbikëqyre mënyre e zbatimit të planit individual të mbikëqyrjes duke marrë për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje;

1.7. harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e drejtorisë rajonale për drejtorinë e përgjithshme.

#### **Neni 15**

#### **Detyrat e Udhëheqësit të Drejtorisë Rajonale**

1. Detyrat e Udhëheqësit të Drejtorisë Rajonale janë me sa vijon:

- 1.1. është përgjegjës për drejtimin, koordinimin, bashkëpunimin dhe kontrollin e përmbushjes së detyrave të Drejtorisë Rajonale;
- 1.2. bashkëpunon dhe lidh marrëveshje me institucione publike dhe organizata joqeveritare për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative në nivel rajonal;
- 1.3. mban kontakte dhe bashkëpunon me gjykata, prokurori, institucione korrektuese dhe institucione tjera;
- 1.4. mban kontakte dhe raporton në drejtorinë e përgjithshme;
- 1.5. mbikëqyrë dhe vlerëson rezultatet e punës së zyrtarëve si dhe mbikëqyrë dhe koordinon të gjitha aktivitetet e drejtorisë rajonale;
- 1.6. kryen detyra të tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesës së udhëheqësit;
- 1.7. Udhëheqësi i Drejtorisë Rajonale për punën e tij i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.

#### **Neni 16**

#### **Detyrat e Zyrtarit Sprovues të Shërbimit Sprovues të Kosovës**

##### 1. Detyrat e zyrtarit sprovues janë me sa vijon:

- 1.1. përpilon raportin para shqiptimit të dënimit, për madhorët dhe anketën e plotë sociale për të miturit;
- 1.2. realizon mbikëqyrjen, korrektimin, risocializimin dhe ri integrimin në shoqëri të personave nën mbikëqyrje;
- 1.3. mbikëqyrë personat të cilët janë liruar me kusht si dhe ndihmon ri integrimin e tyre në shoqëri;
- 1.4. përpilon plane dhe programe individuale për rastet që janë në mbikëqyrje;
- 1.5. harton raporte vlerësues të personave që janë nën mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues të Kosovës, si dhe bënë propozime për revokimin e dënimit;
- 1.6. bashkëpunon me të gjitha institucionet tjera të cilat mbështesin synimin për ndihmë personave nën mbikëqyrje;
- 1.7. mbikëqyrë programin e rehabilitimit, tretmanit mjekësor, për personat nën mbikëqyrje të cilët janë të varur nga droga dhe alkooli;
- 1.8. me kërkesë të organeve gjyqësore, merr pjesë gjatë seancës gjyqësore;
- 1.9. kryen detyra të tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesës së udhëheqësit.

#### **Neni 17**

#### **Zyrtarët Publik të Shërbimit Sprovues të Kosovës**

##### 1. Zyrtarët Publik të Shërbimit Sprovues të Kosovës janë:

- 1.1. nëpunësit civil, dhe
- 1.2. nëpunës administrativ dhe mbështetës.

##### 2. Zyrtarët Publik të Shërbimit Sprovues sipas ligjit për zyrtarët publik janë nëpunës civil.

### **Neni 18** **Të Drejtat e Personelit të SHSK-së**

1. Përveç të Drejtave që janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publik, personeli i SHSK-së ka edhe këto të drejta specifike:

1.1. Zyrtarët Publik të SHSK-së për shkak të ekspozimit ndaj rrezikut të lartë dhe të drejtpërdrejt me të liruuar me kusht nga burgu, të dënuarve me dënime alternative, kushteve të veçanta të punës, si dhe ekspozimit të rrezikut në vendin e punës dhe gjatë vizitave në familje, gëzon shtesë ne page për rrezikshmëri në pune;

1.2. Kategorizimi i personelit të SHSK-së që përfiton shtesë mbi pagë për rrezikshmëri do të rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri i Drejtësisë.

2. Zyrtarët Publik të SHSK-së gëzojnë të gjitha të drejtat sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 19** **Trajnimit profesionale të zyrtarëve publik të SHSK-së**

1. Drejtoria e Përgjithshme e SHSK-së përgjigjet për hartimin dhe zhvillimin e strategjisë së trajnimit profesional të zyrtarëve publik të SHSK-se për përmirësimin e rolit të tyre dhe përgjegjësiive profesionale.

2. Programi i trajnimeve hartohet në dy (2) drejtime kryesore:

2.1. Trajnimi bazik;

2.2. Trajnimi i vazhdueshëm.

### **Neni 20** **Mbrojtja e të dhënave**

1. Zyrtarët Publik të Shërbimit Sprovues të Kosovës gjatë ushtrimit të detyrës janë të detyruar të ruajnë dhe trajtojnë informacionet ne pajtim me legjislacionin përkatës ne fuqi.

2. Zyrtarët Publik të SHSK-së i ndalohet të bëjnë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave nën mbikëqyrje si dhe të dhëna me karakter konfidencial.

3. Zyrtarët Publik të SHSK-së janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 21** **Detyrimi për shmangien nga konflikti i interesit**

Zyrtarët Publik të SHSK-së nuk lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesit. Zyrtarët Publik të SHSK-së veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

### **Neni 22** **Publiciteti i punës**

1. Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHSK-së, drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave zyrtar e informojnë opinionin për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative dhe personave të liruuar me kusht për punën dhe proceset në SHSK, vetëm nëse me Ligj është parapare ndryshe.

2. Për të mitur zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të mitur.
3. Drejtori i Përgjithshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshje të veçantë mund të lejojë qasje në dokumente sipas kërkesës së organizatave të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

#### **Neni 23**

#### **Shkeljet disiplinore dhe masat disiplinore**

Shkeljet, procedura dhe masat disiplinore për zyrtarët publik të SHSK-së zbatohen në pajtim me ligjin për zyrtarët publik.

#### **Neni 24**

#### **Mbikëqyrja për Shërbimin Sprovues të Kosovës**

Mbikëqyrja e punës për SHSK behet sipas legjislacionit në fuqi.

### **KAPITULLI IV**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 25**

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas këtij Ligji vlejné aktet nënligjore të cilat janë në fuqi nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji.

#### **Neni 26**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-129**

**14 korrik 2022**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-248/2022, datë 01.08.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**